

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

Trajtimi dhe përpunimi i qumështit

(Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to, 7.7; e Trajtimi dhe përpunimi i qumështit”, sipas shtojcës I të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)

SUBJEKTI: “AGI 11” shpk

NIPT: L18406102A

ADMINISTRATORI: Grisejda Çela

VENDODHJA: Bashkia Kuçovë, Qarku Berat

1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Përshkrimi i instalimit: “AGI 11” sh.pk është një kompani e specializuar në prodhimin e produkteve të qumështit. Punon nën një teknologji moderne dhe është inspektuar nga punëtorë të trajnuar, që përfshin inxhinierë, teknologë ushqimorë dhe punëtorë të kualifikuar. Në këto fabrike janë të punësuar fermerë lokalë nga rajoni i Beratit. Projekti është mbështetur dhe financuar nga IPARD. Në këto objekt janë instaluar të gjitha pajisjet e prodhimit, paketimit dhe ruajtjes së produkteve deri në shitjen e tyre.



Fabrika e përpunimit të qumështit ndodhet në territorin e Bashkisë Kuçovë, në një distancë ajrore afro 3 km nga qendra e qytetit. Qendra e banuar më e afërt është fshati Tapi në të cilin bën pjesë edhe territori ku ushtron aktivitetin kompania “Agi 11” shpk.



Harta e vendndohjes

Objekti lidhet me qendrën e qytetit me anë të infrastrukturës ekzistuese në këtë zonë (segmenti me ngjyrim lejla), gjithashtu me anë të rrugës ekzistuese lidhet me fshatin Tapi (segmenti me ngjyrim të kuq).

Metodat: Prodhimi i djathrave, salces se kosit, gjizez dhe gjalpiti në këto fabrike kryhet me ane të instalimeve që janë kryer. Në objekte ndodhet të gjitha makineritë e nevojshme nga pasterizimi i qumshtit deri në trashjen e tij, kalimin e tij nëpërmjet formave, kriposjen, kullimin e me pas paketimin e tij.

Proceset kryesore dhe ato ndihmëse:

Proceset kryesore në këto veprimtari janë:

- a. Mbledhja e qumshtit, pra sigurimi i lëndës së parë;
- b. Grumbullimi i qumshtit në tankun fillestar
- c. Në aty qumshti kalon në procesin e pasterizimit në pasterizator;
- d. Me pas qumshti kalon në tankun e ftohjes;
- e. Me pas qumshti kalohet në vaskat dhe makineritë specifike të prodhimit të djathrave të ndryshëm (djath pice, feta, mozzarella etj) për salcë kosi dhe gjalp;
- f. Pasi produkti të ketë marrë trajtën e duhur aji kalon në vaskën e shëllirës;
- g. Me ane të ashensorit produktet e djathit kalojnë në karrocet e kullimit;

Në përfundim produkti shkon në paketim

- **Makinerit e linjes se perpunimit te qumshtit**

Veshjet personale	Doreza, veshje mbrojtese, kepuce, kokore mbrojtese me pelhure.
Formatrice	Eshte nje paisje e cila perdoret per perpunimin e preparatit dhe dhenien e forms se djathit
Makineri denzifektimi	Ketu kryhet densifektimi I duarve dhe kembeve per çdo hyrje dalje.
	Makineria per perpunimin e djathit te bardhe dhe djathit me feta
	Tanku ftohes per mbrojtjen e qumshtit
	Pasterizator per pasterizimin e qumshtit
	Makineri per kthimin e djathit te bardhe ne feta
	Fuso rose makineri per djathin e pices gjysem te gatshem
	Karroca per kullimin e djathit per pica (mozzarella)
	Makineri gjalpi (per larjen e gjalpit)
	Vaska me shellire
	Transportier per djtahin e pices
	Elevator per marrjen e brumit nga tanku tek makineria
	Makineria e prodhimit te mozzarelles
	Polovalente ose tanku ku zihet qumshti qe behet brum
	Kazan per gjizen
	Cip larese
	Skremues gjalpi dhe homogjenizator qumshti

- **Produktet**

Produktet	Gajlp I freske
	Mozzarella
	Ricotta
	Kaçkavall
	Affumicata
	Scamorza
	Ciligini
	Gorgonzola
	Gouda
	Salce kosi
	Gjize
	Djath I bardhe

- **Si kontrollohet qumështi dhe të gjitha prodhimet e tjera deri te ambalazhimi**

Që nga momenti kur milet dhe transportohet për në fabrikë qumështi transportohet në temperaturë 2 deri 4°C. Më pas kryhen analizat për të parë yndyrën, bakteret, parazitët etj. Me pas trajtohet me një teknologji totalisht italiane për të garantuar standartet maksimale të cilesisë.

E gjithë kjo punë për të kënaqur konsumatorin me produkte të shëndetshme dhe të sigurta.

Fabrika furnizohet me qumësht si lëndë e parë nga ferma të shëndetshme nga sëmundjet, që realizojnë mjelje mekanike me higjenë të lartë, pa prezencën e antibiotikëve. Kjo është arritur nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me fermerët si edhe me specialistët veterinerë që operojnë në zone.

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS DHE MASAT PËR MINIMIZIMIN E TYRE

Mjedisi është gjithmonë i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jetë i ndryshëm, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtpërdrejtë, të tërthortë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në tërësi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në një rreth prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi aktiviteti është ekzistues dhe ndikimi në mjedis do të jetë vetëm gjatë ushtrimit të aktivitetit. Nuk marrin në konsideratë fazën pas përfundimit të veprimtarisë pasi ky aktivitet do të vazhdojë i tillë dhe pas shumë kohësh.

Masat që duhen konsideruar për të minimizuar ndikimin në mjedis janë :

- Duhet të tregohet kujdes në respektimin rigoroz të kushteve teknike në fabrikë për të reduktuar mundësitë e rënies së zjarrit në objekt dhe avaritë në sistem duke shmangur kështu dëmtimet në mjedisin e zonës përreth.
- Lidhur me mbetjet e grumbulluara duhet që shoqëria të bëjë trajtimin e herëpashershëm të tyre që mos të grumbullohen për periudha të gjata kohore në ambientet e brendshme të fabrikës.
- Sasia depozituese e mbetjeve të mos i kalojë volumet e parashikuara në mënyrë që situata të jetë e kontrollueshme dhe të mos dëmtoj instalimin.
- Të zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri në mënyrë që të minimizohen rreziqet për jetën e punonjësve dhe mjedisin përreth.

- Punonjësit të jenë të trajnuar paraprakisht dhe të jenë vazhdimisht në mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjatë proceseve të punës. Punimet e mirëmbajtjes të kryhen në përputhje me kushtet teknike të punës.
- Të mirëmbahet brezi i pemëve pergjatë murit rrethues të pronës, në mënyrë që të reduktoj impaktin në peisazh.

Masa të tjera lehtësuese ,për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e furnizimit për mbushje gazi dhe karburant:

- Të kujdeset për mbarëvajtjen e aktivitetit, si dhe punonjësitë që punojnë nën mbikëqyrjen e drejtuesit teknik.
- Të rehabilitohen ambjentet e jashtme të aktivitetit për një mjedis të pastër dhe sa më estetik.
- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruara në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohen nga AKM.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhornohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijoj infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.

DEKLARATË

Duke nënshkruar këtë deklaratë, në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ligjit “Per lejet e mjedisit” dhe akteve nënligjore përkatëse unë paraqes kërkesën për leje mjedisi/ rishikimin e lejes së mjedisit.

Konfirmoj që informacioni i dhënë në këtë kërkesë është i vërtetë, i saktë dhe i plotë.

Unë nuk kam vërejtje lidhur me bërjen publike të kësaj Kërkese , për aq sa nuk bie ndesh me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin e të dhënave tregtare.

Emri i nënshkruesit: Grisejda Cela

Pozicioni brenda Kompanisë: Administrator